

PUNA DHE DREJTËSIA SOCIALE

LIGJI GJERMAN PËR KONTROLLIN E DETYRUESHËM NË ZINXHIRËT E PRODHIMIT:

IMPLIKIMET PËR MBROJTJEN E PUNËTORËVE DHE MJEDISIT NË SHQIPËRI

Edlira Xhafa
Maj 2023



Ligji Gjerman i Kontrollit të Detyrueshëm në Zinxhirët e Prodhimit detyron kompanitë e mëdha të ngrenë një sistem menaxhimi të rreziqeve ndaj të drejtave të punëtorëve dhe ambientit në kompanitë me të cilat punojnë.



Ngushtimi i hendekut rregullator si edhe tendencat për ri-zhvendosje të prodhimit në rajone si Ballkani Perëndimor, krijojnë kushte për përmirësimin e situatës dëshpëruese të punëtorëve dhe ambientit në Shqipëri.



Sindikatat e reja demokratike dhe grupet ambientale mund ta përdorin Ligjin për të nxitur furnitorët vendas që të negociojnë paga e kushte më të mira pune, respektim të të drejtave të punëtorëve dhe mbrojtje të ambientit.

Përmbajtja

1. HYRJE	4
2. LIGJI I KONTROLLIT TË DETYRUESHËM PËR ZINXHIRËT E PRODHIMIT: ELEMENTËT DHE VLERËSIMI	5
2.1 Elementet kryesore të Ligjit	5
2.2 Një vlerësim paraprak i Ligjit: Kufizimet dhe mundësitë	6
3. IMPLIKIMET E LIGJIT PËR VENDET PRODHUESE: RASTI I SHQIPËRISË	8
3.1 Për qeverinë shqiptare	9
3.2 Për sindikatat dhe grupimet në mbrojtje të të drejtave punëtore dhe mjedisit	10
3.3 Për furnitorët shqiptarë.....	11
4. PËRFUNDIME	12
5. BIBLIOGRAFI	13

1.

HYRJE

Shkelja e të drejtave themelore të punëtorëve/eve dhe shfrytëzimi i mjedisit, hasen shpesh në zinxhirët globalë të prodhimit, sidomos në segmentet e poshtme të tyre. Kjo është arsyeja pse gjithmonë e më shumë po cilësohen zinxhirë globalë të shfrytëzimit (Thomas, 2020). Sipas Organizatës Botërore të Punës (*International Labour Organisation-ILO*):

„Dështimet në të gjitha nivelet e zinxhirëve globalë të prodhimit kanë kontribuar në defiçite të punës dinjitoze përsa i përket shëndetit dhe sigurisë në punë, pagave, dhe orëve të punës... Këto dështime kanë kontribuar në minimin e të drejtave punëtore, veçanërisht të lirisë së organizimit dhe të kontraktimit kolektiv. Informaliteti, format jo standarde të punësimit dhe përdorimi i kontraktuesve ndërmjetës, janë të zakonshme në zinxhirët e prodhimit. Prania e punës së fëmijëve dhe e punës së detyrueshme në segmentet e poshtme të këtyre zinxhirëve është akute. Emigrantët/et dhe punëtorët/et që punojnë nga shtëpia ndodhen në shumë prej këtyre zinxhirëve dhe mund të përballen me forma të ndryshme diskriminimi, si dhe mungesë të plotë apo të pjesshme të mbrojtjes ligjore. Së fundmi, gratë përfaqësojnë një pjesë të madhe të forcës punëtore në shumë sektorë të zinxhirëve të prodhimit. Ato janë të mbipërfaqësuar në punët me paga të ulëta sidomos në nivelet e poshtme të këtyre zinxhirëve, si dhe përballen shpesh me diskriminim, ngacmime seksuale dhe forma të tjera të dhunës në vendin e punës. Për më tepër, atyre u mungon qasja në masat e mbrojtjes sociale në përgjithësi, si dhe ato që lidhen me lehoninë në veçanti...” (ILO, 2016: 1-2)

Rol thelbësor në këto dështime ka patur hendeku i thellë rregullator në lidhje me përgjegjësitë e kompanive kryesuese për kushtet e punës në zinxhirët e tyre prodhues (Lorenzen, 2022). Mekanizmat privatë të kontrollit dhe llogaridhënies për respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe ato të punëtorëve/eve, të njohura si përgjegjësia shoqërore e korporatave (*Corporate Social Responsibility*) kanë dështuar në përmirësimin e të drejtave punëtore (Lorenzen, 2022; Anner, 2019).

Sipas shumë studiues/eve, përfshirë Lorenzen dhe Anner, një ndër arsyt kryesore për këtë dështim është karakteri vullnetar i tyre. Ndërkohë, shkeljet e të drejtave të punëtorëve/eve në zinxhirët globalë të prodhimit nuk janë rastësore. Ato janë pjesë integrale e një modeli biznesi që e zhvendos prodhimin në vende me kosto më të ulëta të krahut të punës, çka përfshin jo vetëm paga më të ulëta, por edhe ligje të dobëta për mbrojtjen e punëtorëve/eve dhe të drejtave të tyre dhe/ ose zbatimimi problematik i këtyre ligjeve. E njëjta gjë vlen edhe për mjedisin: kompanitë shumëkombëshe shfrytëzojnë kuadrin e pasigurtë ligjor për mjedisin dhe zgjedhin strategjikisht, që t'i zhvendosin proceset më ndotëse të prodhimit në vende ku këto ligje janë akoma në fazë embrionale (Sharpe 2017).

Përballë këtij dështimi të mekanizmave privatë, si dhe hendekut rregullator për respektimin e të drejtave të punëtorëve/eve dhe ruajtjes së mjedisit në vendet prodhuese, vërehet një rritje e masave rregullatore në fushën e biznesit dhe të drejtave të njeriut në vendet, ku konsumohen kryesisht mallrat e këtyre zinxhirëve të prodhimit. Ligji gjerman me emërtimin e koklavitur *Lieferkettensorgfaltspflichtengesetz* - Ligji i Kontrollit të Duhur të Detyrueshëm të Zinxhirëve të Prodhimit¹ (shkurtimisht Ligji për Zinxhirët e Prodhimit ose thjesht Ligji) - është një prej tyre.

Ky artikull synon të trajtojë disa prej elementeve kryesore të këtij Ligji si edhe implikimet për forcimin e respektimit të të drejtave punëtore dhe mbrojtjes mjedisore në Shqipëri.

¹Termi në anglisht që i referohet ky dhe ligje të tjera të ngjashme, është *“Mandatory Due Diligence in Global Supply Chains”*. Përkthimi “Kontrolli i Duhur i Detyrueshëm i Zinxhirëve Globalë të Prodhimit” është një përpjekje që ka për qëllim kuptimësimin e termit dhe jo përkthimin fjalë për fjalë.

2.

LIGJI I KONTROLLIT TË DETYRUESHËM PËR ZINXHIRËT E PRODHIMIT: ELEMENTËT DHE VLERËSIMI²

I miratuar më 11 qershor 2021, Ligji hyri në fuqi më 1 Janar 2023. Përgatitjet për hartimin e Ligjit filluan pas një vlerësimi nga qeveria gjermane, sipas së cilit vetëm 17% e kompanive gjermane me më shumë se 500 punëmarrës/e, e kryejnë kontrollin e duhur të të drejtave të njeriut në mënyrë vullnetare (Lorenzen, 2022).

Ligji bazohet mbi Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (*UN Guiding Principles on Business and Human Rights, UNGP*) - përdorur në formë të shkurtuar "Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara" - miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB-së në 2011. Sipas tyre, ndërsa kompanitë kanë detyrimin të respektojnë të drejtat e njeriut, qeveritë duhet të garantojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Cilat janë disa prej elementeve kryesore të Ligjit?

2.1 Elementet kryesore të Ligjit

Ligji u kërkon kompanive të përpiqen të shmangin dhe minimizojnë rreziqet, që u kanosen të drejtave të njeriut dhe mjedisit në zinxhirët e tyre të prodhimit. Në mënyrë të veçantë Ligji përmend ndalesat në lidhje me shkeljen e të drejtave të organizimit dhe kontraktimit kolektiv, skllavërinë dhe punën e detyrueshme, si dhe punën e fëmijëve dhe diskriminimin. Pengesat ligjore ose rreziqet që kompanitë duhet të shmangin renditen në mënyrë të detajuar në Ligj (Tabela 1)³.

²Diskutimi i elementeve të Ligjit mbështetet në publikimet e Lorenzen (2022); Kolev dhe Neligan, 2022; Grabosch (2021).

³Për të qartësuar me tej pikën 9, Tabela 1 është plotësuar me referencë direkte të versionit anglisht të Ligjit, të aksesuar më 13 mars, 2023 këtu: https://www.bmas.de/SharedDocs/Downloads/DE/Internationales/act-corporate-due-diligence-obligations-supply-chains.pdf?__blob=publicationFile&v=4

Tabela 1. Rreziqet ndaj të drejtave të njeriut dhe mjedisit (riprodhuar nga Grabosch, 2021:2)

Rreziqet ndaj të drejtave të njeriut:

1. Moshë minimale e punës
2. Format me të këqija të punës së fëmijëve
3. Puna e detyrueshme
4. Të gjitha format e skllavërisë
5. Siguria në vendin e punës në ndërmarrjen prodhuese, veçanërisht:
 - a) Vendi i prodhimit apo mjetet e prodhimit, që janë qartazi të pasigurta;
 - b) Mungesa e mbrojtjes së përshatshme nga materialet kimike, fizike apo biologjike;
 - c) Mungesa e parandalimit të lodhjes së tepërt fizike dhe mendore;
 - d) Trajnimi dhe udhëzimet e punëmarrës/eve janë të pakënaqshme;
6. Liria e organizimit (formimi, anëtarësimi dhe veprimi në sindikata)
7. Barazia në punësim, pavarësisht prejardhjes, origjinës, gjendjes shëndetësore, paaftësisë, orientimit seksual, moshës, seksit, opinionit politik, besimit fetar apo botëkuptimit, duke përfshirë paga të barabarta
8. Paga dinjitoze (mundësisht më të larta se paga minimale në vendin e prodhimit)
9. Ndryshime që dëmtojnë mjedisin (tokën, ujin, ajrin, emetimet e dëmshme të zhurmave dhe përdorimin e tepruar të ujit) duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm për njerëzit
10. Deprivim i jashtëligjshëm i tokës, pyjeve dhe ujit që iu shërben njerëzve
11. Përdorimi i forcave policore që ushtrojnë dhunë jo proporcionale, veçanërisht kundër anëtarë/eve të sindikatave
12. Çdo sjellje tjetër që përbën shkelje të detyrës për të vepruar që mund të shkaktojë shkelje të të drejtave të njeriut në mënyrë veçanërisht të rrezikshme dhe që është qartazi e jashtëligjshme në këto kushte.

Rreziqe mjedisore:

1. Prodhimi apo përdorimin e mërkurit dhe trajtimin e mbetjeve të mërkurit
2. Prodhimi dhe përdorimi i ndotësve organikë si edhe trajtimi, grumbullimi, magazinimi dhe riciklimi i këtyre ndotësve
3. Exporti dhe importimi i mbetjeve të rrezikshme

Fusha e zbatimit të kontrollit të detyrueshëm

Në vitin e parë (2023) subjekt i Ligjit janë kompanitë me më shumë se 3,000 punëmarrës/e, të cilat kanë selinë kryesore, vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit të biznesit ose një zyrë të regjistruar, në Gjermani. Përlllogaritjet e numrit të kompanive që mbulohej nga Ligji në vitin e parë, variojnë nga rreth 600 (Lorenzen, 2022) në 900 (GiZ në Kolev dhe Neligan, 2022). Duke nisur prej vitit 2024, Ligji do të aplikohet në kompanitë me 1,000 punëmarrës/e, çka do do ta rrisë numrin e kompanive të mbuluara nga ky Ligj, nga rreth 2,900 (Lorenzen, 2022) në 4,800 (GiZ në Kolev dhe Neligan, 2022). Edhe kompanitë me më pak se 1,000 punëtorë/e mund të preken nga Ligji, nëse janë furnitore të kompanive të mëdha.

Përsa i përket shtrirjes së kontrollit, Ligji përcakton detyrimin e kompanive për të ngritur një sistem efektiv të menaxhimit të rreziqeve në fushën e tyre të biznesit, çka mbulon kompaninë dhe degët e saj, përfshirë edhe degët ndërkombëtare që konsiderohen pjesë e vetë kompanisë nëse kjo e fundit ka 'ndikim domethënës' (*decisive influence*⁴) mbi to. Detyrimi për ngritjen e këtij sistemi lind edhe për furnitorët e drejtpërdrejtë (niveli i parë i zinxhirit të prodhimit) të kompanisë. Përsa i përket furnitorëve të tërthortë (niveli i dytë i zinxhirit e më tutje), detyrimet lindin vetëm kur e kërkojnë rrethanat dhe kur kompania merr 'informacion të mbështetur në fakte' (*substantiated knowledge*) rreth shkeljeve të mundshme. Ky informacion mund të sigurohet nga burime të ndryshme, përfshirë ankesat e marra përmes mekanizmave të ankesave, raporte nga OJQ-të, sindikatat dhe nga agjencitë shtetërore.

Detyrimet që lindin nga kontrolli i detyrueshëm

Kompanitë që janë subjekt i Ligjit duhet të ndërmarrin masat e mëposhtme në veprimtarinë e tyre dhe të furnitorëve të drejtpërdrejtë:

- Deklarim të një politike mbi respektimin e të drejtave të njeriut;
- Zbatim të një procedure për identifikimin e ndikimeve negative mbi të drejtat e njeriut (analiza e rreziqeve);
- Pjesëmarrje në menaxhimin e rreziqeve, përfshirë edhe masat për të parandaluar dhe minimizuar rreziqet, dhe për të shmangur impaktet e mundshme negative mbi të drejtat e njeriut;

⁴Për një përcaktim më të saktë të termit, 'ndikim domethënës' (*decisive influence*) siç parashikohet në frymën e Ligjit, mund të vizitohet faqja zyrtare e Ministrisë Federale të Punës dhe Çështjeve Sociale, e aksesuar më 13 mars, 2023 këtu: <https://www.csr-in-deutschland.de/EN/Business-Human-Rights-Supply-Chain-Act/FAQ/faq.html#doc3a956fcc-c35e-4655-a96a-6a39a1a0a2cfbodytext4>

- Krijim të një mekanizmi ankimes me rregulla, procedura të shkruara dhe të vëna në dispozicion publikisht edhe për furnitorët e tërthortë, në mënyrë që personat e prekur të kenë mundësinë për të raportuar rreziqet dhe shkeljet; si dhe
- Raportim publik transparent.

Siç u përmend më sipër, kompanisë i lindin detyrime edhe kur merr informacion të mbështetur në fakte për shkelje nga furnitorë të tërthortë. Në këtë rast, kompania duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme, çka përfshin kryerjen e një analize rreziqesh, zbatimin e një strategjie për të minimizuar dhe shmangur problemin, si dhe vendosjen e masave parandaluese.

Sanksionet

Zyra Federale për Çështje Ekonomike dhe Kontroll të Eksporteve (*Federal Office for Economic Affairs and Export Control*) është në krye të monitorimit të zbatimit të detyrimit për kontrollin e detyrueshëm. Ajo shqyrton raportet e kompanive dhe ankesave (p.sh. nga një palë e dëmtuar) dhe vendos sanksione nëse është e nevojshme. Këto sanksione mund të arrijnë maksimalisht deri në €800,000 ose 2% të xhiros totale vjetore për kompanitë e mëdha. Kompanitë që gjobiten më shumë se €175,000 përjashtohen nga tenderat publike deri në tre vjet.

2.2 Një vlerësim paraprak i Ligjit: Kufizimet dhe mundësitë⁵

Ligji vlerësohet se përfaqëson një ndryshim paradigmatic, duke e zëvendësuar karakterin vullnetar të vetërregullimit nga kompanitë, me detyrimin ligjor për të vepruar në përputhshmëri me Ligjin (Graboch, 2021: 1). Gjithashtu, sipas Lorenzen, ky Ligj "është i pari tekst legjislativ, i cili u kërkon qartësisht kompanive të zhvillojnë dhe zbatojnë praktika blerëse që parandalojnë rreziqet ndaj të drejtave të njeriut", çka ka potencialin të ndryshojë sjelljen e korporatave (2022: 454). Në të njëjtën kohë, ai përmban sanksione administrative të forta (gjoha, përjashtim nga prokurimi publik) dhe artikulon për herë të parë detyrimin ligjor për kontroll të detyrueshëm specifikisht për mjedisin (ibid.). Së fundmi, duke qenë se sindikatat dhe OJQ-të mund të paraqesin pretendime në emër të palëve të dëmtuara, Ligji ndihmon që të reduktohen kostot e procedurave dhe të sigurohet anonimiteti për këto padi (Lorenzen, 2022).

⁵Për të plotësuar analizën në këtë pjesë të artikullit, autorja i është referuar gjithashtu versionit anglisht të Ligjit, i aksesuar më 13 mars, 2023 këtu: https://www.bmas.de/SharedDocs/Downloads/DE/Internationales/act-corporate-due-diligence-obligations-supply-chains.pdf?__blob=publicationFile&v=4

Ndërkohë, Ligji ka marrë edhe kritika. Sipas Lorenzen, disa elemente të tij që “e bëjnë të debatueshme nëse Ligji e favorizon përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut për punëtorë/et dhe komunitetet apo nëse do të mbetet një projekt i orientuar drejt procesit e kësaj me efekt të kufizuar” (2022: 455). Për shembull, Lorenzen vëren se fusha e zbatueshmërisë së Ligjit shtrihet vetëm në kompanitë e mëdha, edhe pse kufiri mund të ulet më tej pas vlerësimit mbi ndikimin e Ligjit. Ndërkohë, detyrimi për kontroll të detyrueshëm do të aplikohet në fushën e biznesit së vetë kompanisë dhe vetëm për furnitorët e drejtpërdrejtë (Lorenzen, 2022; Boll, 2021). Sipas Lorenzen, klauzola ‘ndikim domethënës’ lë vend për një interpretim të ngushtë të shtrirjes së kontrollit në nivelin e parë të furnitorëve. Ky lloj interpretimi bie ndesh me frymën e Parimeve Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara (UNGP), që synon tejkalimin e kufizimit të përgjegjësive përgjatë akteve të territorialitetit, të personave juridikë apo të nivelit të furnitorëve, për të siguruar një qasje që bazohet në rreziqet që i kanosen të drejtave të njeriut. Realizimi i këtij tejkalimi është veçanërisht kritik duke pasur parasysh, që rreziqet më të rënda që i kanosen këtyre të drejtave, ndodhin në nivelet e poshtme të zinxhirëve të vlerës (industri nxjerrëse ose prodhuese). Ky formulim i klauzolës mund t’i nxisë kompanitë që të mos i shqyrtojnë rreziqet potenciale, për të shmangur kështu marrjen e ‘informacionit të mbështetur në fakte’ për shkelje të mundshme, që fundja do të binte ndesh me përpjekjet për transparencë.

Gjithashtu, Ligjit i mungon përgjegjësia ligjore e kompanive për dëmet e shkaktuara nga neglizhenca e detyrimit për të kryer kontrollin e duhur (Boll, 2021). Ndërkohë, Ligji nuk e parashikon qartazi as pjesëmarrjen reale në proces dhe as kompensimin efektiv për ata/o që preken nga shkeljet (ibid.). Duket ama se Ligji mund t’u lejojë palëve të dëmtuara, që t’i drejtohen drejtpërdrejt Zyrës Federale përgjegjëse për monitorimin e Ligjit, për informimin mbi shkeljet që rezultojnë nga mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara nga kontrolli i detyrueshëm (Seksioni 14 i Ligjit). Së fundmi, Ligji është kritikuar për vëmendjen e cekët lidhur me çështjet mjedisore; kontrolli i detyrueshëm për këto çështje nuk zë vend konkret dhe nuk është gjithëpërfshirës (Boll, 2021).

Në nivel më të përgjithshëm, Lorenzen (2022) nënvizon çështjen e “asimetrive të pushtetit” (*power asymmetries*) midis kompanive dhe furnitorëve: nëse nuk ndryshojnë praktikave të kontratave të blerjes, kostot shtesë të kontrollit të detyrueshëm u mbetën furnitorëve. Kjo mund të çojë në mbulimin e shkeljeve të mundshme nga këta furnitorë ose në intensifikimin e tendencës së firmave kryesuese për të lëvizur nga një vend në tjetrin, çka mund të shkaktojë falimentim të konkurruesve të vegjël e përqendrim të tregut në furnitorë të mëdhenj. Sipas Lorenzen (2022), shmangia e këtij skenari do të kërkonte më shumë bashkëpunim me furnitorët, si p.sh. ndarje kostosh, rritje

kapacitetesh dhe monitorim. Edhe pse Ligji nuk i referohet në mënyrë eksplicite detyrimit për ndryshime në kontratat porositëse (*purchasing practices*) midis kompanive kryesuese dhe furnitorëve, ai lë vend për t’u interpretuar se masat prandaluese nga kompanitë kryesuese duhet të përfshijnë siguri kontraktuale nga furnitorët e drejtpërdrejtë, që të veprojnë në përputhje me pritshmëritë për të drejtat punëtore dhe mjedisore (Seksioni 6 i Ligjit).

Pavarësisht kritikave, sic u përmend më sipër, Ligji pritet të ketë efekt domethënës dhe të sjellë ndryshime të rëndësishme. Një anketë me më shumë se 1,000 kompani gjermane mbi efektin e këtij Ligji, tregon se kostot e larta të operimit në përputhje me Ligjin kanë gjasa t’i motivojnë këto kompani për t’i tërhequr aktivitetet e tyre nga vendet në zhvillim me qeverisje të dobët (Kolev dhe Neligan, 2021: 4). Sipas kësaj ankete, Ligji prek drejtpërdrejt ose tërthorazi 41% të kompanive të anketuara, ku kompanitë e mëdha dhe ndërkombëtare zënë një vend të konsiderueshëm. Anketa tregon gjithashtu, se 8% e kompanive të anketuara kanë në plan të ndërpresin furnizimin për kompanitë që preken nga Ligji; 12% planifikojnë të largohen nga vendet me qeverisje të dobët; 18% raportojnë se do të operojnë vetëm me furnitorë nga vende që respektojnë standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mjedisit; dhe një në pesë kompani planifikon të rrisë çmimet e produkteve për të faktorizuar rritjen e kostove që lindin nga të vepruarit në përputhshmëri me Ligjin. Ironikisht, këto gjetje vetëm sa e përforcojnë argumentin, që një ndër arsytet e zhvendosjes së prodhimit në vende të caktuara, ka qenë pikërisht mungesa e kontrollit për shkeljen e ligjeve në këto vende.

3.

IMPLIKIMET E LIGJIT PËR VENDET PRODHUESE: RASTI I SHQIPËRISË

Ligji gjerman, por edhe mundësia që së shpejti të ketë një ligj në nivel të Bashkimit Evropian (BE), mund të krijojë mundësi të reja për të ushtruar presion mbi çështjet punëtore dhe mjedisore në Shqipëri. Kjo është veçanërisht e vlefshme kur merret parasysh rëndësia në rritje e Gjermanisë si partner tregtar me Shqipërinë (Figura 1).

Sipas të dhënave të marra nga Zyra Federale për Marrëdhëniet e Jashtme (*Foreign Federal Office*), Gjermania është tashmë partneri i katërt tregtar më i madh për Shqipërinë.⁷ Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri ka një anëtarësi që përfshin 83 kompani si gjermane, shqiptare dhe austriake. Sipas të njëjtit burim, kompanitë gjermane operojnë më së shumti në degët e tregtisë dhe logjistikës. Ndërkohë, në diskutimet për zinxhirët e prodhimit në BE, po bëhet gjithnjë e më e qartë tendenca për shkurtim të zinxhirëve të prodhimit dhe rihvendosje të prodhimit më pranë qendrave të konsumit (*near-shoring*) si përgjigje ndaj pandemisë, por edhe situatës së paqëndrueshme globale; këtui vëmendja po drejtohet gjithnjë e më shumë nga vendet e Ballkanit

⁶Grafik i marrë nga: <https://www.ceicdata.com/en/albania/exports-by-country-annual/exports-all-europe-germany>

⁷Faqja zyrtare e *Federal Foreign Office*: <https://www.auswaertiges-amt.de/en/aussenpolitik/albania/229546>

Perëndimor⁸.

Një anketë me 46 kompani gjermane të madhësive të ndryshme, hedh dritë mbi arsyet e këtyre kompanive për të investuar jashtë Gjermanisë (WIIW, 2021). Kështu, anketa tregon se faktorët më të rëndësishëm janë diponueshmëria e krahut punëtor të kualifikuar, si dhe stabiliteti e cilësia e qeverisjes dhe institucioneve vendore. Renditja pasohet nga pagat dhe vendndodhja gjeografike; taksat dhe paketat lehtësuese qeveritare gjenden në fund të listës. Ndërkohë, sipas një ankete tjetër të WIIW (2021) me 74 kompani gjermane që operojnë aktualisht në Ballkanin Perëndimor, vërehet se arsyet kryesore përse ato kanë investuar në këtë rajon janë: paga relativisht të ulëta, pozicioni gjeografik, si dhe një forcë punëtore e kualifikuar. Përsa i përket sfidave të operimit në rajon, lista kryesohet nga qeverisja dhe institucione të dobëta, ndjekur nga skemat mbështetëse qeveritare dhe gatishmëria e krahut të punës.

⁸Për shembull, Tryeza e Rrumbullakët e organizuar nga Dhoma Federale e Ekonomisë në Austri në janar 2023 pati për fokus pikërisht zhvendosjen potenciale të prodhimit në këto vende. Aksesuar më 20 mars, 2023 nga: <https://wiiw.ac.at/nearshoring-trends-in-see-what-is-ahead-e-605.html>

Figura 1: Niveli i eksporteve të Shqipërisë në Gjermani: 2009-2020⁶



Në rastin e Shqipërisë, investitorët gjermanë vlerësojnë pozicionin gjeografik të vendit që e bën lehtësisht të arritshëm tregun evropian dhe fleksibilitetin e punëtorëve/eve. Ndërkohë, sipas Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, investitorët vlerësojnë pagat konkurruese (ibid.). E megjithatë, këto nuk duken të jenë të mjaftueshme. Kështu, një në tre kompani raportojnë të jenë të pakënaqura me përvojën e tyre në Shqipëri; përqindja më e lartë krahasuar me të gjitha vendet e rajonit. Së fundmi, në prill 2023, pesë Dhoma të Tregtisë në Shqipëri - Dhoma Amerikane, Gjermane, Franceze, Italiane si dhe Konfindustria shqiptare - dolën me një deklaratë të përbashkët për t'i kërkuar qeverisë shqiptare hartimin e një strategjie zhvillimi për tërheqjen e investimeve përmes nxitjes së punësimit, luftës kundër korrupsionit, besueshmërisë në prokurimet publike dhe dialogit me grupet e interesit⁹.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të analizohet domethënia e Ligjit për Kontrollin e Detyrueshëm për qeverinë, sindikatat dhe kompanitë shqiptare.

3.1 Për qeverinë shqiptare

Siç u përmend më lart, disa prej arsyeve kryesore që mund të detyrojnë kompanitë gjermane të ndërpresin marrëdhëniet me furnitorë nga një vend i caktuar, është stabiliteti dhe situata e qeverisjes së një vendi. Sipas Indikatorëve të Efektivitetit Qeverisës nga Banka Botërore, Shqipëria rezulton ndër vendet e cilësuar me efektivitet të dobët qeverisës. Lidhur ngushtë me vlerësimin e këtij efektiviteti qëndron dhe treguesi i korrupsionit (Figura 2). Edhe pse ka shënuar një përmirësim të lehtë të situatës sipas Transparency International, Shqipëria mbetet ndër vendet më të korruptuara në Evropë (Euractiv, 2023). Ajo e gjen veten midis vendeve si Lesoto, Kazakistani, Panamaja dhe Sri Lanka, ndërkohë që është më keq sesa Moldavia, Etiopia, Kolumbia dhe Tunizia (ibid.).


Situata në lidhje me rreziqet që u kanosen të drejtave punëtoresh dhe mjedisore, çka pikërisht shënjestrohet edhe në Ligjin gjerman, është dëshpëruese.

⁹Voice of America. „Tiranë: Korrupsioni dhe klima e biznesit, pesë Dhoma Tregtie kërkojnë reformism,“ Aksesuar më 20 Prill, 2023 nga: <https://www.zeriamerikes.com/amp/7045035.html>

Kështu, edhe pse Shqipëria nuk ka boshllëk të dukshëm ligjor, zbatimi i ligjit të punës mbetet thellësisht problematik. 'Pagat konkurruese' të cituara nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe 'fleksibiliteti' i vlerësuar nga investitorët gjermanë janë veçse gjuhë e koduar për punëtorë/e tejet të shfrytëzuar/a. Shqipëria vlerësohet të ketë pagat më të ulëta në rajon gati në të gjithë sektorët, përfshirë arsimin, shëndetësinë, shërbimet, bujqësinë, financat dhe biznesin (Monitor, 2023b). Në fakt, një studim i Eurofound tregon që pagat janë aq të ulëta sa gati 70% e shqiptarëve/eve nuk arrijnë të plotësojnë nevojat mujore (Euronews Albania, 2023). Gjithashtu, një raport i Komisionit Evropian, vëren se punëtorët/et shqiptare punojnë shumë më gjatë se të ngjashmit e tyre në Evropë (Monitor, 2023a). I njëjti raport vëren se orët e gjata të punës çojnë në sëmundje të ndryshme si depresioni, ankthi, çrregullimet e gjumit dhe sëmundje të zemrës (ibid.). Kjo përbën një prej rreziqeve kryesore të përcaktuara nga Ligji i Kontrollit të Detyrueshëm, 'Mungesë e parandalimit të lodhjes së tëpërt fizike dhe mendore' (pika 5c, Tabela 1). Në të njëjtën kohë, shkeljet e shumta nga punëdhënësi/et gjatë procesit të formimit të sindikatave, përfshirë edhe akte të diskriminimit të sindikalistëve/eve, vazhdojnë të ngelen përgjithësisht të pandëshkuara. Gjithashtu, këto shkelje klasifikohen si rreziqe kryesore që mbuloohen nga Ligji, dhe më specifikisht nga 'Liria e organizimit (formimi, anëtarësimi dhe veprimi në sindikata)' (pika 6, Tabela 1).

Ndërkohë, qeveritë shqiptare kanë treguar mungesë kronike të vullnetit politik për t'u përballur me situatën problematike të shkeljeve të legjislacionit të punës, madje kanë kontribuar aktivisht në përkeqësimin e saj. Ky perceptim manifestohet, për shembull, në dobësimin e strukturave ligjzbatuese, si Inspektoriati Shtetëror i Punës, i cili ka pasur një ulje të vazhdueshme të numrit të inspektorëve/eve edhe pse ekonomia shqiptare është e dominuar nga ndërmarrje të vogla dhe shumë të vogla. Deklaratat famëkeqe të kryeministrit shqiptar qofshin këto në takim me kompanitë italiane, ku ai i fton këto të fundit të investonin në Shqipëri në mungesë të sindikatave¹⁰ apo në takime me kompani shqiptare, ku ai

¹⁰Deklarata vazhdon të qëndrojë e postuar në faqen e internetit të Kryeministrit: Konferencë e përbashkët e Kryeministrit Edi Rama dhe Kryeministrit italian, Matteo Renzi, Dhjetor 2015. Aksesuar më 1 mars, 2023 nga: <https://www.kryeministria.al/newsroom/itali-Shqipëri-dakordesi-për-të-jetësuar-njohjen-e-pensioneve-2/>



premtonte lehtësimin e hyrjes së emigrantëve nga Bangladeshi për të zëvendësuar fuqinë punëtore shqiptare, të paktën deri sa ata/o të mësojnë gjuhën e të fillojnë të flasin për liri e demokraci¹¹ - e përforcojnë këtë perceptim. Shkrija e Ministrisë së Punës ishte akti përfundimtar, që shpalosi jo vetëm mungesën e vullnetit politik, por edhe të interesit për çështjet punëtore.

Situata e (keq)qeverisjes sa i përket çështjeve mjedisore paraqet të njëjtën problematikë: ndërsa kuadri ligjor është përmirësuar gradualisht¹², probleme serioze hasen në zbatimin e ligjit për disa arsye, përfshirë mungesën e instrumenteve monitoruese, hendekun në menaxhim, paqartësi në buxhetin e caktuar për strategjinë mjedisore, si dhe mungesë apo pamjaftueshmëri trajnimi (WFD, 2021; Misho 2019). Madje ndonjëherë, legjislacioni është shumë më i avancuar sesa kapacitetet administrative, institucionale dhe financiare (WFD, 2021).

Mundësia e thithjes apo largimit të investimeve gjermane në Shqipëri, do të duhet të ishte çështje e rëndësishme veçanërisht duke patur parasysh, që tërheqja e investimeve të huaja deklarohet të jetë prioritet kryesor i qeverisë shqiptare. Kjo duket të jetë e vërtetë për sektorin e pasurive të paluajtshme që aktualisht po përjeton një flluskë spekulative, e cila në një treg të parregulluar ka gjasa të ndiqet nga një krizë financiare dhe rrezik stagflacioni¹³ afatgjatë (Dodig dhe Herr, 2014). Për sektorët prodhues, qeveria deri më tash është mjaftuar me strategjinë e pagave të ulëta dhe lehtësimin e procedurave për të sjellë emigrantëve/e, çka ka sjellë largim masiv të punëtorëve/eve të kualifikuar/a nga vendi. Ndërkohë, për tërheqjen e investimeve të huaja, fokusi i politikave qeveritare është në krijimin e lehtësirave fiskale, strategji e cila ngushton akoma më shumë hapësirën financiare për të investuar në forcimin e kapaciteteve profesionale të punëtorëve/eve dhe të infrastrukturës publike për zhvillim.

Mbetet për t'u parë nëse deklaratat e fundit për rritje rrogash¹⁴ vijnë nga një reflektim i sinqertë për situatën alarmante të krijuar nga emigracioni i punëtorëve/eve të kualifikuar/a apo jane thjesht premtime elektorale. Gjithsesi, modeli qeverisës i ndjekur prej 2013 sugjeron se ka shumë pak gjasa që kjo qeveri ta marrë seriozisht nevojën urgjente për të forcuar kapacitetet ligj-zbatuese në lidhje me të drejtat punëtore dhe çështjet mjedisore me nismën e

saj. Presioni nga aktorët e tjerë të do të jetë vendimtar për të nxitur transformimin e modelit aktual, të dështuar zhvillimor.

3.2 Për sindikatat dhe grupimet në mbrojtje të të drejtave punëtore dhe mjedisit

Siç u përmend më sipër, efekti më i fortë i Ligjit gjerman për zinxhirët e prodhimit është mbi furnitorët e drejtpërdrejtë. Gjasat janë që kompanitë shqiptare të jenë më shumë furnitorë të tërthortë të kompanive gjermane. Kjo do të thotë se sindikatat dhe grupimet e ndryshme për mbrojtjen e punëtorëve/eve dhe mjedisit, do të duhet të luajnë një rol proaktiv për t'i përdorur mundësitë që krijon Ligji.

Është me rëndësi të qartësojmë se referenca është për sindikatat e reja. Sindikatat ekzistuese zyrtare, kanë treguar se janë tërësisht të paafta për të ushtruar ndonjë lloj presioni për zbatimin e ligjit, madje në disa raste janë rreshtuar kraher pronarëve dhe kundër kërkesave legjitime punëtore për kushte më të mira pune dhe paga më të larta (Xhafa, 2022; Xhafa 2020). Në këtë pikëpamje, prandaj ato nuk përbëjnë ndonjë vlerë për këtë diskutim.

Sindikatat e reja hasin vështirësi shumë të mëdha në formimin e funksionimin e tyre veçanërisht duke patur parasysh modelin e dështuar zhvillimor të ndjekur nga qeveritë shqiptare përgjatë tri dekadave të fundit dhe situatën dëshpëruese të zbatimit të ligjit. Në këtë kontekst, Ligji gjerman paraqet një levë të mundshme për të ushtruar presion.

Për furnitorët e drejtpërdrejtë, Ligji i përcakton qartësisht detyrimet për të kontrolluar respektimin e të drejtave punëtore dhe mbrojtjes se mjedisit, çka dhe mund t'i japë hov organizimit sindikal në këta furnitorë. Mirëpo, siç u përmend më sipër, Ligji është kritikuar për mbulimin e dobët të pjesës më të rrezikuar të zinxhirit të prodhimit. Sipas Ligjit, kompanitë kryesuese duhet të veprojnë vetëm nëse marrin 'informacion të mbështetur në fakte' për shkelje të të drejtave punëtore dhe dëmtim të mjedisit. Këtu roli i sindikatave të reja dhe grupimeve për mbrojtjen e mjedisit është thelbësor, pasi gjasat janë që shumë prej kompanive shqiptare të jenë furnitorë të tërthorta të kompanive gjermane. Për shembull, Shqipëria është furnizuese e rëndësishme e Italisë me prodhime të ndërmjetme në sektorin e veshjeve dhe të këpucëve, të cilat pas proceseve përfundimtare në Itali, mund të eksportohen në tregun gjerman. Në këtë rast, sindikatat e reja apo grupimet në mbrojtje të të drejtave të punëtorëve/eve mund të fillojnë të identifikojnë ndërmarrje, që në mënyrë të tërthortë janë të lidhura me kompani gjermane dhe ta prioritojnë organizimin sindikal aty. Në mënyrë të ngjashme, këto sindikata dhe grupimet për mbrojtjen e mjedisit mund të punojnë së bashku për të evidentuar shkelje që dëmtojnë mjedisin dhe vënë në rrezik jetën e

¹¹ABC News Albania. "Rama këshillon sipërmarrësin: merr punëtorë të huaj nga Bangladeshi, s'merren as me thashetheme". Aksuar më 1 mars, 2023 nga: <https://www.youtube.com/watch?v=27dhZ7uyNZ0>

¹²Edhe pse ka mungesa të aktëve nën-ligjore për Ligjin për Ndryshimin e Klimes (WFD, 2022).

¹³Stagflacioni njihet si rezultat i natyrshëm i pompimit të parave në ekonomi, çka ul ritmin e rritjes ekonomike dhe në të njëjtën kohë shton normën e rritjes së çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.

¹⁴Top-channel 2023. "Rriten pagat e administratës/ Rama: Brenda vitit paga mesatare shkon në 900 euro". Aksuar më 20 Prill, 2023 nga: <https://top-channel.tv/2023/04/07/rriten-pagat-e-administrates-rama-brenda-vitit-paga-mesatare-shkon-ne-900-euro8/>

njerëzve (pikat 9 dhe 10 në Tabelën 1). Në të njëjtën kohë, është me rëndësi kyçe që të zhvillohet një strategji gjithëpërfshirëse për ngritjen e kapaciteteve të këtyre grupeve, si edhe për vendosjen e kontakteve të ngushta me sindikata dhe grupime mjedisore në Gjermani. Konkretisht, institucione si FES, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

3.3 Për furnitorët shqiptarë

Deri më tani, kompanitë shqiptare që prodhojnë për kompanitë e huaja, kanë përdorur si avantazh konkurrues kryesisht pagat e ulëta dhe punën jashtë orarit. Kështu, përballë mungesës së fuqisë negociuese me kompanitë kryesuese, shumë furnitorë shqiptarë kanë ndjekur rrugën e shrytëzimit të egër të punëtorëve/eve dhe mjedisit – rruga dritëshkurtër e zhvillimit (*low road*) – duke ia kaluar kostot komuniteteve lokale dhe më gjerë, gjithë shoqërisë.

Por ka edhe një rrugë tjetër zhvillimi, me një qasje morale superiore që respekton punëtorët/et dhe mjedisin (*high road*). Kjo është rruga e konkurrencës përmes pagave dhe kushteve dinjitoze të punës, lirisë së organizimit sindikal dhe kontraktimit kolektiv, zhvillimit të kapaciteteve profesionale të punëtorëve/eve dhe mbrojtjes së mjedisit. Ligji gjerman krijon hapësira për këtë rrugë të qëndrueshme zhvillimi, çka do të sillte edhe përmirësimin e pozicionit në zinxhirët e prodhimit për kompanitë vendase, që veprojnë si furnitorë të drejtpërdrejta apo të tërthorta të kompanive gjermane.

Kështu, furnitorët shqiptarë mund të vendosin të organizohen kolektivisht jo vetëm për interesa tregtare, siç kanë bërë deri më tani, por edhe për t'i vendosur qeverisë kërkesa për t'iu larguar njëherë e mirë rrugës dritëshkurtër të zhvillimit. Në të njëjtën kohë, ky organizim kolektiv mund të luajë një rol kritik në përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave punëtoresh dhe marrëdhënieve të punës më gjerësisht. Organizatat e furnitorëve, sindikatat e reja dhe grupimet për çështjet mjedisore mund të formojnë forume apo këshilla sektoriale për të hartuar një strategji zhvillimi gjithëpërfshirëse. Këto struktura mund luajnë rol akoma më të fortë nëse një grup furnitorësh hyn në kontraktim kolektiv me sindikatat e reja demokratike, për paga e kushte më të mira pune, respektim të të drejtave të punëtoresh dhe të mjedisit, duke tërhequr kështu punëtorët/et më të kualifikuar/a. Në një situatë, ku ka një boshllëk të dukshëm të këtyre punëtorëve/eve, kjo do të përbënte një strategji shumë efektive për të luftuar konkurrencën e pandershme nga furnitorë që shkelin të drejtat e punëtorëve/eve dhe dëmtojnë mjedisin. Shërbimet e këtyre strukturave mund të zgjerohen në çështje të tjera si programe kualifikimi për punëtorët/et dhe ndërtim kapacitetesh për punëdhënësit/et për aplikimin

e legjislacionit të punës.

Një strategji e tillë zhvillimi, mund të shënjestrojë deri diku 'asimetritë e pushtetit' në zinxhirët e prodhimit duke i çuar kompanitë vendase në një pozicion më të fortë për negociimin e kontratave më të favorshme me kompanitë gjermane, përfshirë ndarjen e kostove për zbatimin e ligjeve të punës dhe mjedisit, ndërtim kapacitetesh dhe monitorim, siç thekson me sipër edhe Lorenzen (2022). Së fundmi, kjo strategji mund të luajë edhe një rol frenues në situatën alarmante të emigracionit të punëtorëve/eve të kualifikuar/a.

4.

PËRFUNDIME

Forca e një ligji përcaktohet nga zbatimi i të drejtave dhe realizimi i mundësive që premtion. Pavarësisht kufizimeve, Ligji gjerman mund të krijojë disa rrethana për një ndryshim domethënës të situatës së respektimit të të drejtave punëtore dhe mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri. Parakusht për këtë është materializimi i vullnetit politik nga qeveria, për të ndryshuar situatën dëshpëruese të respektimit të këtyre të drejtave. Në situatën aktuale, kjo lloj pritshmërie duket një skenar jorealit. Pavarësisht deklaramëve publike, prioriteti kryesor i qeverisë në tërheqjen e investimeve është i fokusuar në sektorin e pasurive të paluajtshme. Strategjia për sektorët prodhues është zëvendësimi i punëtorëve/eve shqiptarë/e me emigrantë/e që mund të shfrytëzohen më tepër dhe krijimi i lehtësirave fiskale për investitorët. Prej këtu, çdo lloj ndryshimi i mundshëm i kursit të politikave qeveritare do të kërkojë presion nga aktorë të tjerë. Edhe pse akoma në fazë embrionale, sindikatat e reja dhe grupimet e ndryshme në mbrojtje të mjedisit mund të luajnë një rol kritik duke përdorur mekanizmin e mbledhjes së fakteve në lidhje me rreziqet e përcaktuara në Ligjin gjerman për të ushtruar presion mbi qeverinë dhe kompanitë vendase që prodhojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për kompanitë gjermane. Kompanitë shqiptare, të interesuara për të mbajtur e tërhequr investimet e huaja, mund ta përdorin këtë mundësi për t'u bashkuar në organizata sektoriale për të negociuar përmirësimin e pagave dhe kushteve të punës dhe mbrojtjes së mjedisit me sindikatat e reja demokratike, çka do të luante një rol të rëndësishëm në luftën ndaj konkurrencës së pandershme. Forumet dhe këshillat sektoriale të furnitorëve vendas, të sindikatave të reja dhe të grupeve në mbrojtje të mjedisit, mund të shërbejnë për hartimin e një strategjie zhvillimore sektoriale.

Këto janë ide të paprovuara më parë në Shqipëri, por kanë potencialin të përcjellin ndryshim thelbësor të modelit konkurrues të një grupi të caktuar të kompanive shqiptare me ndikim përtej tyre, duke i vënë sadopak fre situatës alarmante të emigrimit të punëtorëve/eve të kualifikuar/a. Në të njëjtën kohë, ky model mund të fuqizojë pozicionin e kompanive vendase në negociatat me kompanitë kryesuese gjermane. Së fundmi, ky lloj bashkëpunimi i sindikatave të reja, grupimeve mjedisore dhe kompanive vendase për të mbajtur e tërhequr më shumë investime të huaja, mund të ketë ndikim edhe në kursin e politikave qeveritare dhe modelin zhvillimor të vendit.

5.

BIBLIOGRAFI

- Anner, Mark. 2019. Predatory purchasing practices in global apparel supply chains and the employment relations squeeze in the Indian garment export industry. *International Labour Review*, 158(4), 705–727.
- Boll, Frederike. 2021. German Supply Chain Act makes corporate responsibility mandatory. Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: <https://asia.fes.de/news/german-supply-chain-act>
- Euractiv. 2023. Albania improves slightly in corruption index, remains among Europe's worst. Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: <https://www.euractiv.com/section/politics/news/albania-improves-slightly-in-corruption-index-remains-among-europes-worst/>
- Euronews Albania, 2023. 70% of Albanians run out of money before the end of the month. Aksesuar me 8 Mars, 2023 nga: <https://euronews.al/en/70-of-albanians-run-out-of-money-before-the-end-of-the-month/>
- Grabosch, Robert. 2021. The Supply Chain Due Diligence Act: Germany sets new standards to protect human rights. FES: Labour Law and Social Justice. Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: <https://library.fes.de/pdf-files/iez/18755.pdf>
- Lorenzen, Stéfanie. 2022. New business and Human Rights Law – Support for social upgrading?
- Sharpe, S. 2017. Environmental scoping study : decent work in the garment supply chains in Asia. Report prepared for the International Labour Organisation.
- ILO (International Labour Organisation). 2016. Resolution concerning decent work in global supply chains. Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---relconf/documents/meetingdocument/wcms_497555.pdf
- Dodig, Nina dhe Herr, Hansjörg. 2014. Previous financial crisis leading to stagnation: Selected case studies. Working Paper No. 33/2014.
- Hochschule für Wirtschaft und Recht Berlin, Institute for International Political Economy (IPE), Berlin
- Kolev, Galina dhe Neligan, Adriana. 2022. Effects of a supply chain regulation: survey-based results on the expected effects of the German Supply Chains Act. Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: <https://www.iwkoeln.de/studien/galina-kolev-adriana-neligan-survey-based-results-on-the-expected-effects-of-the-german-supply-chains-act.html>
- Misho, Erinda. 2019. The Development of Environmental Law in Albania: Historical Overview of Efforts toward Full Approximation with the *Acquis Communautaire*. *Balkan and Near Eastern Journal of Social Sciences*, 5(03). Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: https://www.ibaness.org/bnejss/2019_05_03/02_Misho.pdf
- Monitor. 2023a. Orët më të gjata të punës në Europë i kanë meshkujt e femrat shqiptare. Aksesuar me 8 Mars, 2023 nga: <https://www.monitor.al/oret-me-te-gjata-te-punes-ne-europe-i-kanë-meshkujt-e-femrat-shqiptare/>
- Monitor. 2023b. Gara e humbur, pse Shqipëria ka pagat më të ulë në rajon në IT, arsim, shëndetësi, shërbime, bujqësi, financa e bizni Aksesuar me 8 Mars, 2023 nga: <https://www.monitor.al/gara-e-humbur-pse-shqipëria-ka-pagat-me-te-uleta-ne-rajon-ne-it-arsim-shendetësi-shërbime-bujqësi-nanca-e-biznes/>
- Sharpe, S. 2017. Environmental scoping study: decent work in t garment supply chains in Asia. Report prepared for the Internatio Labour Organisation.
- WFD (Westminister Foundation for Democracy). 202 Monitoring of The Climate Change Strategy in Albania, 2020-203 for 2019-2021. Aksesuar më 4 Mars, 2023 nga: https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-01/REC%20EN_Monitoring%20of%20the%20Climate%20Change%20Strategy%2C%20Albania.pdf
- WIIW (Wiena Institute for International Economic Studies). 202 Getting Stronger After COVID-19: Nearshori Potential in the Western Balkans. Aksesuar me 4 Mars, 2023 ng <https://wiiw.ac.at/getting-stronger-after-covid-19-nearshoring-potential-in-the-western-balkans-dlp-5814.p>
- Thomas, Huw. 2020. Pandemic, poverty, and power in glot exploitation chains. *Futures of Work*. Issue 14, // 5th June 2023 Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: <https://futuresofwork.co.uk/2020/06/05/pandemic-poverty-and-power-in-global-exploitation-chain>
- Xhafa, Edlira. 2022. Between yellow affiliates and new independe trade unions: The dilemma of international trade unions. *Global Labour Column*. Aksesuar me 4 Mars, 2023 nga: https://globalbourcolumn.org/2022/11/16/between-yellow-affiliates-and-new-independent-trade-unions-the-dilemma-of-international-trade-unions/?fbclid=IwAR0u9P7JpUtlObtZUTNFniQGu_nUlns65FSey0w2QF-k952kSEJ8o_Cfc
- Xhafa, Edlira. 2020. The difficult birth of an independent lab movement in Albania. *Global Labour Column*. Aksesuar me 4 Ma 2023 nga: <https://globallabourcolumn.org/2020/01/16/algorithms-dta-and-a-new-labour-agenda-2>

MBI AUTOREN

Edlira Xhafa është studuese e çështjeve të punëtorisë dhe aktualisht Drejtore Ekzekutive e Akademisë Online të Global Labour University.

Ajo ka përfunduar masterin në Politikën e Punës dhe Globalizimin në Global Labour University (Gjermani) dhe doktoraturën në Studime të Punës në Universitetin e Milanos (Itali).

Prej vitit 2000, ajo është angazhuar me lëvizjen punëtore fillimisht në Shqipëri, e më pas në Filipine, Bangladesh, Kamboxhia dhe Burma.

Ajo ka punuar në Organizatën Botërore të Punës (ILO) dhe Sindikatën Ndërkombëtare të Arsimit (*Education International*), si edhe ka bashkëpunuar me sindikatat ndërkombëtare si Sindikata Ndërkombëtare e Shërbimeve Publike (*Public Services International*) dhe Sindikata Ndërkombëtare e Punëtorëve të Ndërtimit dhe Pyjeve (*Building and Wood Workers' International*).

IMPRINT

Fondacioni "Friedrich Ebert" | Rr. "Kajo Karafili", Nd. 14, Hyrja 2, Kati 1 | Tiranë | Shqipëri

Përgjegjës:

Stine Klapper | Drejtoreshë e Fondacionit "Friedrich Ebert", Zyra e Tiranës

Tel: +355 4 22 509 86 / 733 06

<https://tirana.fes.de/>

Menaxher Programi:

Genci Lamllari

Përdorimi tregtar i të gjitha materialeve mediatike të publikuara nga Fondacioni «Friedrich-Ebert» (FES) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES-it.

LIGJI GJERMAN PËR KONTROLLIN E DETYRUESHËM NË ZINXHIRËT E PRODHIMIT



Ligji Gjerman i Kontrollit të Detyrueshëm në Zinxhirët e Prodhimit (*Lieferkettensorgfaltspflichtengesetz*) ngushton hendekun rregullator, që ka kontribuar në probleme serioze të të drejtave të punëtorëve dhe të ambientit në këta zinxhirë. Ligji i detyron kompanitë e mëdha gjermane të ngrënë një sistem efektiv të menaxhimit të rreziqeve që i kanosen të drejtave të punëtorëve dhe ambientit në kompanitë me të cilat ato punojnë. Zbatimi i Ligjit mbështetet nga një zyrë e posaçme që kontrollon raportet e kompanive, heton shkeljet dhe vendos sanksione, përfshirë përjashtimin e kompanive nga tenderat publikë. Pavarësisht kufizimeve, Ligji shënon një ndryshim të rëndësishëm pasi



zëvendëson karakterin vullnetar të vetë-rregullimit nga kompanitë me detyrimin për të vepruar në përputhshmëri me Ligjin. Ky Ligj si edhe aprovimi së shpejti i një ligji të ngjashëm në Bashkimin Europian, krijon mundësi për vende si Shqipëria për të ndryshuar situatën dramatike të të drejtave të punëtorëve dhe ambientit. Për më tepër, situata e paqëndrueshme globale ka sjellë një tendencë të kompanive kryesuese për të shkurtuar zinxhirët globalë të prodhimit dhe ri-zhvendosur prodhimin më pranë, në rajone si Ballkani Perëndimor. Disponueshmëria e punëtorëve të kualifikuar, stabiliteti, dhe cilësia e qeverisjes dhe institucioneve, janë faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimet e kompanive gjermane për investime. Deri më tash, kompanitë shqiptare kanë konkurruar përmes pagave të ulëta dhe shfrytëzimit të



tejskajshëm të punëtorëve, çka ka sjellë emigrim masiv të punëtorëve të kualifikuar. Ndërkohë, Shqipëria vazhdon të konsiderohet vend me qeverisje problematike. Një ndryshim kurs nga qeveria aktuale, duket skenar jo-realist. Sindikatat e reja, demokratike dhe grupimet ambientale mund të përdorin hapësirat që krijon Ligji për të ushtruar presion mbi furnitorët shqiptarë, për të negociuar paga e kushte më të mira pune, si edhe respektim të të drejtave të punëtorëve dhe të ambientit. Edhe pse e paprovuar më parë, kjo strategji mund të jetë efektive për të ndikuar kursin qeverisës, si edhe për të luftuar konkurrencën e pandershme nga kompani që shkelin të drejtat e punëtorëve dhe dëmtojnë ambientin.

Për më shumë informacion:

<https://www.tirana.fes.de/al/publikime/>